

## KRITIKË DHE RECENSIONE

## KOLEC TOPALLI

## PËR ORIGINËN E PASKAJORES NË GJUHËN SHQIPE

(Rreth diskutimit të gjuhëtarit Marco Gabinski)

Në librin “Sistemi foljor i gjuhës shqipe” (Tiranë, 2010, 474 v.) kam paraqitur disa teza të reja për burimin e paskajores së tipit *me punue* të gegërishtes, ku kam vënë në dukje se kjo formë foljore analitike është krijuar vetëm në dialektin e Veriut, prandaj për dialektin e Jugut nuk mund të bëhet fjalë për zhdukje të saj, meqenëse kjo formë nuk ka ekzistuar ndonjëherë në atë dialekt.

Meqenëse tezat e mësipërme janë diskutuar nga gjuhëtari Marco Gabinski në artikullin “*Încă o dată despre originea infinitivului albanez (pe marginea unor publicații recente)*”, botuar në “*Studia linguistica et philologica - Omagiu Profesorului Nicolae Saramandu*” București, 2011, f. 369-375, po lejohej të paraqes mendimet e mia, që nuk pajtohen me vërejtjet e paraqitura nga autori i sipërpërmendur.

- 1) Teza e Gabinskit se paskajorja e tipit *me + pjesore* ka qenë e dy dialekteve, nuk mund të mbahet me shembujt e paraqitur: *domethënë*, *meqenëse* etj. Në literaturën më të vjetër të këtij dialekti, duke filluar me Perikopenë e Ungjillit të Pashkëve, vepërzën e Lekë Matrëngës etj., nuk ka asnjë gjurmë të kësaj forme paskajoreje. Gjurmë të tilla nuk ka në asnjë të folme popullore të atij dialekti. Po të ishin format e sipërpërmendura gjurmë të një përdorimi më të hershëm, ashtu siç ndodh përgjithësisht, në shekujt më të parë të shkrimit të shqipes ato duhej të ishin më të shpeshta. Prandaj, fakti se këto forma paskajoreje janë vetëm me folje që prapashtesat e paskajores janë të njëjta për të dy dialektet, por jo me grupin më të madh të foljeve, ku toskërishtja ndryshon nga gegërishtja (khs. *punue / punuar*, *lye / lyer*), tregon se dialekti i Jugut nuk e ka ndjenjën e paskajores dhe se format e mësipërme, të shfaqura tek autorët e Rilindjes, janë përshtatje të paskajores geqe, nisur nga dëshira e afrimit dialektor, përshtatje që u mundësuan nga ekzistenca e të njëjtave forma të pjesores në dialektin gegë (khs. geg. *thanë*, *qenë* ~ tosk. *thënë*, *qenë*). Me këtë shpjegohet përse me pjesoret *larë*, *pirë*, *quajtur*, *mbajtur* etj. nuk gjendet asnjë formë paskajoreje në toskërishte, meqenëse me një formë foljore me

- kuptim kohor të së shkuarës dhe me karakter jovepror nuk mund të krijohet një formë foljore me kuptimin e paskajores.
- 2) Shembujt e tjerë që sjell autori nga të folmet arbëreshe të Italisë (*vjen me thënë, vjen me rarë, për me bërë* etj.), nuk përbëjnë provë të qëndrueshme për ekzistencën e paskajores së tipit *me + pjesore* në dialektin toskë, meqenëse ndër emigrantët e ikur nga Shqipëria ka pasur edhe një shumicë prej trevave geqe, që kanë marrë me vete edhe të folmen e tyre, ku paskajorja është formë e gjallë që nga ajo kohë e deri në ditët e sotme. Me këtë shpjegohet fakti se forma të tilla paskajoresh tek arbëreshët e Italisë gjenden jo vetëm në vepra autorësh, por edhe në të folme popullore.
  - 3) Format *duke me bërë, tuk me bërë*, që shfaqen tek ndonjë autor jo vetëm tek arbëreshët, por edhe përkëtej Adriatikut, në vend që të dëshmojnë ekzistencën e paskajores në toskërishte, provojnë pikërisht të kundërtën, meqenëse këto forma janë krijime autorësh, që s'i ka gegërishtja, ku ndjenja e paskajores është shumë e fuqishme; prandaj ato nuk mund të jenë krijime me karakter popullor as në dialektin e Jugut. Fakti se krahas formës *duke me bërë* tepër e rrallë dhe vetëm në shkrime autorësh, ekziston edhe forma *duke bërë*, shumë më e shpeshtë dhe me karakter popullor, dëshmon se forma e parë është krijim i vonë intelektualësh; kurse e dyta është shumë më e hershme dhe krijim gjuhësor me karakter popullor. Si rrjedhim, jo vetëm nga një paskajore analitike nuk mund të krijohet një formë përcjelloreje, por vetë forma analitike e paskajores me parafjalën *me* në toskërishte është frut i krijimtarisë gjuhësore të rilindasve, dhe si e tillë është edhe forma tjetër *duke me bërë*.
  - 4) Formimi i paskajores analitike prej përcjellores është i papranueshëm për gjuhën shqipe. Fakti i përdorimit të përcjellores në vend të paskajores me foljet që shprehin fillim veprimi (foljet inkohative), nuk mund të shërbejë si argument për të vërtetuar origjinën e paskajores prej përcjellores. Ndërtime të tilla, si: *nisi me folë* e *nisi tue folë*, janë me karakter nëndialektor e krahinor dhe dëshmojnë përzierjen e këtyre formave në të folme të veçanta. Përzierje të tilla janë bërë të mundura për arsye se me folje të tilla krijohet një tog foljor me një kuptim të vetëm semantik dhe me kuptimin aspektor të fillimit të një veprimi, ku folja e parë i jep grupit kategoritë gramatikore (kohë, mënyrë aspekt), kurse folja e dytë i jep atij kuptimin semantik.
  - 5) Meqenëse toskërishtja nuk e ka pasur ndonjëherë formën e paskajores *me bërë*, nuk mund të flitet për zhdukje të saj, aq më tepër nga ndikimi i greqishtes. Në këtë rast bëhet fjalë për moskrijimin e kësaj forme foljore analitike në dialektin toskë.

Shkaku i moskrijimit të kësaj forme foljore në toskërishte lidhet me një zhvillim të hershëm të atij dialekti: format foljore me diftongje, që përbëjnë tipin më të përhapur (\**blua*, \**lye*) dhe përfaqësonin paskajoren e lashtë të mbarë shqipes, morën që herët prapashtesën *-rë* të pjesores, duke i kthyer paskajoret e trashëguara në pjesore e duke shënuar me këtë dukuri zhdukjen e paskajores së lashtë. Në këtë dialekt nuk janë gjetur askurrkund gjurmë të këtyre formave foljore pa prapashtesë pjesoreje. Por kjo dukuri nuk ndodhi në dialektin gegë, ku format *blue*, *lye* vijojnë të jenë të gjalla edhe sot e kësaj dite. Kjo dukuri i ka dhënë mundësi dialektit gegë që mbi bazën e paskajoreve të lashta të ndërtojë paskajoren analitike, pas së cilës format e paprira nga ndonjë pjesëz morën kuptimin e pjesoreve të shkuara pësore, ashtu si edhe në toskërishte.

